



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE P. - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2022:059356  
Datë: 31.05.2022  
Numri i dokumentit: 03077113

**PPP.nr.67/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG**, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit KRU H.. SH.A me seli në P., kundër debitorit F.T.A me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 2,172.65 €, duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga ana e debitorit me dt.10.08.2020, kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbarimit, jashtë seancës me datën 31.05.2022, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET PJESËRISHT** prapësimi i debitorit F.T.A me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, ashtu që:

**II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhri mbi Lejimin e Përmbarimit P.nr.585/2020, i dt: 16.03.2020, për periudhën kohore 01.01.2015 e gjerë më 31.12.2018 në shumë prej 2,011.69 €, dhe **OBLIGOHET** debitorit F.T.A me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, që kreditorit KRU H.. SH.A me seli në P., në emër të borxhit për ujin e shpenzuar për periudhën kohore 31.01.2019 gjer me 29.02.2020, t'ia paguaje shumën prej 160.96 €, me kamat ligjore prej 8% nga pranimiti i këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Kreditori, KRU H.. SH.A me seli në P., ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit F.T.A me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, në emër të borxhit për ujin e shpenzuar për periudhën kohore 01.01.2015 e gjer me 29.02.2020, në shume totale prej 2,172.65 €, me kamat ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbarim të dt. 13.03.2020.

Përmbaruesi Privat me Urdhrin P.nr.585/2020, i dt: 16.03.2020, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, F.T.A me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, me kërkesë që të anulohet urdhri përmbarimor dhe të pezullohet procedura përmbarimore me arsyetimin se ka kaluar afati ligjor që mund të kërkohej përmbarimi, konkretisht afati ligjor nga neni 382 i LMD-së.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit si dhe e mundësinë e paraqitjes së përgjigjes, por se në shkresë të lëndës nuk ka dëshmi që ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në P. – Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave tjera të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë që të anulohet urdhri përmbarimor dhe të pezullohet procedura përmbarimore me arsyetimin se ka kaluar afati ligjor që mund të kërkohej përmbarimi, konkretisht afati ligjor nga neni 382 i LMD-së, të njëjtat pretendime gjykata gjeti se janë pjesërisht të bazuara, por në rastin konkret nuk mund të vijë në shprehje neni 382 i LMD-së së vjetër edhe për kundër faktit që në Ekstraktin e verifikuar nga librat afarist përcaktohet se një pjesë e borxhit i përket periudhës deri në vitin 2008, mirëpo nga i njëjti ekstrakt vërtetohet fakti se kreditori me debitorin ka lidhur kontratë me nr. 87/2015 për ri programimin e borxhit me dt. 06.11.2015, në 36 këste, ku kësti i fundit për pagës ka qenë me dt. 06.10.2018, nga e njëjta kontratë borxhi deri në 31.12.2008 është fshirë-falure, e konform nenit 368 të LMD-së kemi ndërprerje të parashkrimit, mirëpo edhe për kundër faktit që kemi ndërprerje të parashkrimit, duke u bazuar në nenin 373 par.1 të LMD-së parashkrimi ka filluar të rrjedh përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin ligjor për parashkrim.

Në rastin konkret borxhi kërkohej për periudhën 01.01.2015 deri me 29.02.2020, ku në shprehje vjen, (Ligji nr.04/L-077 Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i dt. 10.05.2012), andaj i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori F.T.A me adresë në Rr. .... nr. K-Istog, për periudhën kohore 01.01.2015 e gjerë më 31.12.2018, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1 të LMD-së, për faktin se debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se ka bërë disa pagesa paushall, mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraprak apo në emër të faturave për muajt vijues, kurse nga ndërprerja e parashkrimit si rezultat i një marrëveshjeje për ri programim të borxhit, ka kaluar përsëri afati ligjor sipas të cilave për periudhën e lartcekur që të mund të kërkohej përmbarimi, andaj këto pagesa nuk e kanë bërë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 368 të LMD-së.

Sa i përket borxhit për periudhën kohore 31.01.2019 e gjerë me 29.02.2020, gjykata, gjeti se i njëjti borxh është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 360, par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), ku parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin 2018, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë me 01.01.2019, dhe në rastin konkret nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka paraqitur me datën 13.03.2020, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Sa i përket kamatës se aplikuar për detyrimin e aprovuar si në piken II të dispozitivit, gjykata u referua nenit 382, par.1 dhe 2 të LMD-së.

Duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, gjykata përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 3, 17, 29 par.1.2, dhe par.3, 37, 38, 69, 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbartimore), në lidhje me nenin 360 par.1 dhe 2, 368 dhe 369, 373 dhe 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.67/2020 dt: 31.05.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.